



Prishtinë, 12.10.2016

**Përgjigjet në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik
për
Shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për NQ Termokos – sezoni 2016/2017**

1. Hyrje

Në përputhje me kërkesat ligjore, me datë 20 shtator 2016, ZRRE ka nxjerrë në konsultim publik Draft Raportin: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për NQ Termokos për sezonin 2016/2017. Me këtë rast të gjithë palët e involvuara dhe publiku i gjerë janë ftuar për të dhënë komentet e tyre në këtë Raport. Po ashtu në kuadër të procesit të konsultimit publik ZRRE, me 4 tetor 2016, ka organizuar seancën publike, ku është prezantuar Raporti si dhe janë dhënë përgjigjet në pyetjet dhe komentet nga palët. Gjatë konsultimit publik ZRRE ka pranuar komentet me shkrim nga NQ Termokos, dhe në vijim janë dhënë përgjigjet në këto komente.

2. Përgjigjet në komentet e pranuar nga NQ Termokos

Koment 1: Kostoja e energjisë termike nga kogjenerimi

a. Komponenta Fikse (Kapacitetet e rezervuara, pika 12. Tabela Nr.1 e Raportit Rregullativ);

Kapaciteti i rezervuar për sezonin 2016/2017 është bazuar në balancën energjetike për vitin 2016 (Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2016) dhe atë të planifikuar për vitin 2017 (Janar, Shkurt, Mars dhe Prill 2017).

Sipas këtyre dy dokumenteve, Termokosi ka planifikuar dhe ka në dispozicion 37,294 MW elektrik. Kostoja për këtë kapacitet, duke marrë parasysh çmimin aktual 19.83 €/MW, të aprovuar nga ZRRE, është:

$$37,294 \text{ MW} \times 19.83 \text{ €/MW} = 739,540.02 \text{ €}$$

b. Komponenta variabile (Energjia e planifikuar , Pika 2. Tabela Nr.1 e Raportit Rregullativ)

Energjia e planifikuar për shpenzim, bazuar në kapacitetet e lejuara dhe koeficientin e efijencës $f=6.56$, për sezonin 2016/17 do të jetë : 244,648.00 MWh termike. Kostoja për këtë energji, duke marrë parasysh çmimin aktual 1.27 €/MWh, të aprovuar nga ZRRE, është:

$$244,648.00 \text{ MWh} \times 1.27 \text{ €/MWh} = 310,702.96 \text{ €}$$

*Në emër të këtyre dy komponentëve, Termokosi duhet ti paguaj KEK-ut vlerën: **1,050,242.98€***

*Nëse shtojmë edhe Taksën Vjetore për Licencim, në vlerë 24,401.00€, atëherë kostoja për energji termike për sezonin 2016/2017 është **1,074,643.98 €***



Përgjigje:

Komenti i mësipërm i NQ Termokos ka të bëjë me vlerën e kostos së blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi në TC Kosova B. Lidhur me këtë sqarohet si në vijim:

- Fillimisht në aplikimin fillestarë NQ Termokos ka paraqitur vlerën prej 1,134,263 €, për të cilën nuk kanë dhënë detaje dhe shpjegime se si është llogaritur.
- Në komentet tona me shkrim të dt. 15 gusht 2016, është kërkuar të ofrohen detaje se si është llogaritur kjo kosto duke dhënë ndarazi komponentën e kapacitetit dhe komponentën e sasisë së energjisë termike.
- Në përgjigjen e NQ Termokos janë dhënë të dhënat e kërkuara dhe detajet e llogaritjes – pra për kapacitetin e rezervuar elektrik është dhënë vlera 37,214 MW_{EL}, të cilën vlerë ne e kemi pranuar si reale dhe të bazuar në Bilancin e energjisë elektrike. Ndërsa në komentet e fundit ju këtë vlerë e ndryshoni në 37,294 MW_{EL}/h/h. Edhe pse është një ndryshim i vogël ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të mëhershme.
- Pra ZRRE bazuar në parashikimet e juaja dhe vlerësimet e veta ka llogaritur koston për kapacitetin e rezervuar si në vijim:

$$37,217 \text{ MW}_{EL} \text{ h/h} \times 19.83 \text{ €/MW}_{EL} \text{ h/h} = 737,954 \text{ €}$$

- Njëjtë si për kapacitetin e rezervuar elektrik, edhe për sasinë e energjisë termike në komentet e fundit kjo vlerë është ndryshuar nga 244,013 MWh në 244,648 MWh pa dhënë asnjë shpjegim shtesë.
- ZRRE ka bërë vlerësimet e veta bazuar edhe në të dhënat e parashikuara nga ju ashtu edhe nga Balanca e energjisë dhe ka llogaritur koston për sasinë e energjisë termike si në vijim:

$$244,013 \text{ MWh} \times 1.27 = 309,897 \text{ €}$$

- Kësaj kostoje ZRRE i ka shtuar edhe vlerën për taksën e licencimit në vlerë 24,401 € dhe përfundimisht kostoja për sasinë e energjisë termike nga kogjenerimi ka rezultuar në:

$$309,897 \text{ €} + 24,401 = 334,298 \text{ €}$$

- Rrjedhimisht vlera përfundimtare e kostos së blerjes së energjisë termike nga kogjenerimi është llogaritur:

$$737,954 \text{ €} + 334,298 \text{ €} = 1,072,252 \text{ €}$$

Koment 2: Kostoja e energjisë elektrike

“Në sezonën paraprake, 2015/2016 (Korrik 2015 – Qershor 2016), për energji elektrike (Prodhim+Distribuim) kemi paguar vlerën 478,767.69€.

Për sezonën 2016/2017 është planifikuar vlera 550,000.00 €. Kjo rritje prej 15% është reale dhe arsyetohet me këto të dhëna:

a. Është planifikuar rritje e energjisë së ekstraktuar për 23 %, nga 198,696.00 MWh në sezonën 2015/2016 në 244,648.00 MWh në sezonën 2016/2017. Rritja e energjisë së ekstraktuar determinon rritjen e energjisë elektrike (pompat e rrjetit të kogjenerimi duhet të punojnë me ngarkesë më të madhe);



b. Nënstationet e rikonstruara (50 nënstacione) kanë shpenzime shtesë të energjisë elektrike pasi që në to janë instaluar 100 pompa me fuqi nga 0.3 kW.

c. Jemi në kontest me KESCO lidhur me saktësinë e matjes së energjisë elektrike për Ngrohtore në vitet e kaluara (KESCO pretendon për korrigjim me koeficient 1.76 për 12 muajt e fundit). Meqenëse tani grupi matës , sipas KESCO, është në gjendje të rregullt, mund të pritët që në këtë sezon kemi me pranuar fatura më të larta për energji elektrike.

Prandaj planifikimi 550,000.00 € për shpenzim të energjisë elektrike, që paraqet rritje për 15% krahasuar me sezonën paraprake, është shumë real dhe në asnjë mënyrë nuk mund të kontestohet.”

Përgjigje:

- Megjithëse arsyet e lartcekura qëndrojnë, ZRRE vlerëson se kjo rritje nuk korrespondon plotësisht me shtimin e numrit të nënstacioneve respektivisht sipërfaqes për ngrohje sepse përqindjet respektive janë dukshëm më të vogla se përqindja e rritjes së kostos së parashikuar të energjisë elektrike.
- Sa i përket kontestit me KESCO-n për korrigjimet e faturimit të energjisë elektrike për shkak të pasaktësisë në matje, ZRRE mendon se, meqenëse ky kontest është në fazën e zgjidhjes, nuk mund të paragjykohet rezultati, dhe rrjedhimisht për këtë periudhë kjo nuk merret parasysh. Sidoqoftë, pas zgjedhjes së kontestit, korrigjimet do merren parasysh në axhustimin për shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- Nga sa u tha më lartë, ZRRE vlerëson se kostoja e lejuar e energjisë elektrike në vlerë prej **450,000 €** është e mjaftueshme për të mbuluar konsumin e tërësishëm të energjisë elektrike për periudhën në fjalë, përfshirë edhe shpenzimet shtesë për shkak të rritjes së sipërfaqes ngrohëse dhe instalimit të pajisjeve shtesë (të reja)

Koment 3: Kostoja e ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohje:

“Ndërmarrja “Termokos” bazuar te Kosto e Ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohje ka paraqitur shumën prej 85,000.00 € bazuar në vitet paraprake (sidomos në periudhën Tetor/2015-Tetor2016, ku kosto e ujit është rreth 83,000.00€ të faturuara dhe të paguara).

Për këtë arsye ne kemi planifikuar që kosto e shpenzimit të ujit të jetë 85,000.00 € që është shume reale. Po ashtu duhet të ju njoftojmë që KUR-Prishtina nga viti 2015 bënë faturimin e të gjitha nënstacioneve të cilat më herët nuk ishin të faturuara ndaj “Termokos”. Gjithsesi, ndërmarrja është duke u angazhuar në aktivitete të shumta riparuese ndaj sistemit të ngrohjes (të cilat do të reduktonin humbjet e krijuara të ujit), por vjetërsia e sistemit ende është mjaft e dukshme dhe bënë që të krijohen humbjet të cilat janë aktuale.”

Përgjigje:

- Për koston e ujit ZRRE ka kryer vlerësimet duke u bazuar në konsumin e parashikuar nga NQ Termokos prej 75,500 m³ dhe tarifat aktuale të shërbimeve të ujit për KRU Prishtina – për shërbimin e ujësjellësit: 0.88 €/ m³ dhe për shërbimin e ujërave të zeza: 0.105 €/m³.



- Nga këto të dhëna ZRRE ka llogaritur koston dhe ka lejuar këtë kosto në vlerë prej 75,000 €, dhe konsideron se janë më se të mjaftueshme për pagesat e ujit të regjistruara nga KUR. Siç u përmend edhe më lartë investimi në rrjet dhe nënstatione këtë sezon (për të cilin janë lejuar edhe fonde përkatëse) duhet të ndikoj pozitivisht për të zvogëluar rrjedhjet e ujit nëpër gypa dhe me këtë rast edhe në zvogëlimin e shpenzimit të ujit. [Posaçërisht ndërrimi i gypave në rrjetin e shpërndarjes në qytet do të ndikoj në zvogëlimin e rrjedhjeve të ujit të ngrohtë, e rrjedhimisht edhe në zvogëlimin e sasisë së ujit për rimbushjen e sistemit, që përgjithësisht ndikon në zvogëlimin e humbjeve të energjisë termike në rrjet.](#)

Koment 4: Kostoja e Personelit

“Kostot e pagave krahasuar me raportimet paraprake janë parashikuar të rriten diku rreth 17%, edhe pse ndërmarrja nuk ka bërë ndonjë detajizim rreth shtimit të punëtorëve apo pagës mesatare, ndërmarrja ka parashikuar që të bëjë një rritje të kësaj kostoje për arsye se kjo kosto në vitet paraprake ishte mjaftë e ultë dhe si e tillë nuk plotësonte nevojat për efikasitet të plotë të punës. Pas implementimit të projektit të kogjenerimit na nevojitet staf shtesë për punë në termo-nënstationit kryesor në KEK si dhe me sistematizimin e ri nevojitet staf shtesë për plotësimin e nevojave të ndërmarrjes. Gjithsesi me realizimin e projektit të kogjenerimit kërkesat për kyçe në sistemin e ngrohjes janë rritur në një masë mjaft të madhe andaj paralelisht me këtë duhet analizuar për një rritje të numrit të punëtorëve në mënyrë që shërbimet ndaj konsumatorëve aktual dhe atyre të rinjë të kryhen me një efikasitet, në mënyrë që edhe performanca e ndërmarrjes të ngritet në nivelin e dëshiruar.”

Përgjigje:

- ZRRE ka vlerësuar se rritja e propozuar nga NQ Termokos nuk përmban detajet e nevojshme si: shtimin e numrit të punëtorëve, shtimin e pagave, pagën mesatare etj, që janë të domosdoshme për të arsyetuar rritjen e propozuar. Po ashtu nuk ka ndonjë zgjerim të dukshëm të operimeve të NQ Termokos që do implikonte shtim të dukshëm të numrit të punëtorëve.
- ZRRE ka vlerësuar se një rritje prej 5% e kësaj kostoje është e arsyeshme me që rast ka lejuar lejon vlerën prej **786,734 €** për Koston e personelit (‘puna direkte’). Gjithashtu sugjeron që ndërmarrja të shtoj produktivitetin i cili është një nder përcaktuesit me kritik të eficiencës në kosto.

Koment 5: Kostoja e Borxheve të këqija

“Kostot e borxheve të këqija janë parashikuar në 10 % nga faturimi për sezonën. Edhe pse krahasuar me vitet paraprake ky parashikim është mjaft modest, gjithnjë duke u bazuar në inkasimet e viteve paraprake ku inkasimi nuk do ta kalonte as 70% (gjë që do të detyronte ndërmarrjen të parashikonte koston e borxheve të këqija në 30% të faturimit). Edhe pse pas realizimit të projektit të kogjenerimit është vërejtur një lëvizje mjaft pozitive nga ana e konsumatorëve rreth pagesave, sistemi i faturimit për ndërtesë ndikon që shumë konsumatorë ta keqpërdorin dhe të mos realizojnë pagesat ndaj obligimeve të tyre për ngrohje.

Sistemi i ngrohjes në ndërtesat e vjetra që përfshin pjesën kryesore më të madhe të konsumatorëve nuk na lejon që të ndërmarrim masa duke i shkyçur konsumatorët borxhlinj që na vështirëson aktivitetin për mbledhjen e te hyrave. Prandaj ne kërkojmë që kosto e borxheve të këqija të jetë siç



kemi propozuar 10% e faturimit, qe është një objektiv shume optimist ne krahasim me të hyrat qe i kemi pasur deri më tani.”

Përgjigje:

- Në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, kostoja e borxhit të keq llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (d.m.th. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes). Kjo ‘përqindje e arsyeshme’ duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivisht nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht e lejon koston e borxhit të keq në vlerën prej **273,447 €**.
- Gjithashtu edhe praktikatat e rregullimit të çmimeve si në vend ashtu edhe ndërkombëtare e përcaktojnë përqindjen e arsyeshme të borxheve të këqija në një nivel prej 5%.

Koment 6: Riparimet dhe Mirëmbajtja

“Paralelisht me realizimin e projektit të kogjenerimit janë rritur edhe kërkesat e konsumatorëve për riparime, si dhe është rritur nevoja për mirëmbajtje të rrjetit në mënyrë më efikase, andaj ndërmarrja ka parashikuar që këto shpenzime do të jenë mjaft të mëdha gjatë periudhës raportuese. Po ashtu duhet pasur parasysh se ndërmarrja deri në këtë vit ka raportuar vetëm për pjesën sezonale, ku është raportuar një vlerë mjaft e ulët për arsye se riparimet dhe mirëmbajtja e rrjetit bëhet gjatë periudhës jashtë-sezonale.”

Përgjigje:

- NQ Termokos për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes ka planifikuar vlerën prej 150,000€ - pra një rritje të dukshme prej 90,350 € ose 151% krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar / sezonin 2015-2016 (59,650 €). Gjithashtu paraqitet rritje prej 63,864 € krahasuar me koston e realizuar sipas Pasqyrave financiare për vitin 2015.
- ZRRE gjatë analizimit të kësaj kostoje dhe duke e krahasuar me sezonet e kaluara ka vlerësuar se këtë sezon ky planifikim i tejkalon koston e zakonshme të riparimeve. Rrjedhimisht ZRRE ka vlerësuar se një rritje e tillë mjaft e madhe nuk është e arsyetuar mjaftueshëm e sidomos nuk reflektohen plotësisht shpenzimet e zakonshme për riparimet dhe mirëmbajtjen që i shkaktohen ndërmarrjes. Duke marrë parasysh shtimin e sipërfaqes ngrohëse gjegjësisht kycjet e reja të planifikuara, sigurimin e një furnizimi cilësor dhe operim të qëndrueshëm të stabilimenteve, pajisjeve dhe rrjetit, konkludohet se një rritje prej rreth 25% në krahasim me koston e realizuar në vitin 2015 është e arsyeshme. ZRRE konsideron që vlera e lejuar prej **107,670 €** për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes në këtë sezon është e arsyeshme dhe reflekton shpenzimet e zakonshme të riparimeve dhe mirëmbajtjes që NQ Termokosi i shkaktohen për ofrimin e shërbimit të ngrohjes qendrore. Çfarëdo tejkalimi i realizimit të kësaj kostoje mund të axhustohet për sezonin e ardhshëm, nëse NQ Termokos dëshmon me të dhëna të sakta se tejkalimi i kësaj kostoje ka qenë i arsyeshëm.



Koment 7: Zbritjet në faturim

“Furnizimi Real te konsumatorët është më i vogël shpesh se sa furnizimi në nivel të nënstacionit për arsye të problemeve teknike brenda ndërtesave dhe si pasojë e mungesës së pajisjeve kontrolluese në nënstacione.

Rrjedhimisht në raste kur jemi të detyruar në faturim me m2 në pamundësi të matjes reale detyrohemi të bëjmë zbritje në faturim.

Problem tjetër po ashtu që ndikon në furnizim sasior dhe cilësor, është lagjja Bregu i Diellit për arsye të disnivelit të relievit ku kemi një reduktim të furnizimit për këtë lagje ku aplikohet një shkëmbim i dytë i nxehtësisë, ku kjo rezulton me një zbritje në faturim.

Problem tjetër është fakti se në rrjetin sekondar, në banesat-shtëpitë e konsumatorëve është sistemi i vjetruar i cili nuk mirëmbahet nga konsumatorët.

Zbritje ne faturim do të ketë edhe në sezonën e ardhshme 2016/2017 dhe në vitet në vazhdim derisa të përfundojnë investimet në rehabilitimin e rrjetit dhe të nënstacioneve, e sidomos deri sa të bëhet rehabilitimi i nënstacioneve dhe vendosja e pajisjeve rregulluese.”

Shënim ZRRE: Në komentet e NQ Termokos është edhe tabelari i zbritjeve në faturim por që për shkak të formatit të këtij dokumenti nuk e kemi vendosur këtu. Përndryshe tabelori gjendet në dokumentin: Komentet e NQ Termokos që është bashkangjitur dosjes së shqyrtimit tarifor.

Përgjigje:

- Komenti/ sqarimi i NQ Termokos i paraqitur më lartë është dërguar në forme elektronike pas seancës së konsultimit publik, dhe pastaj është nënshkruar dhe dërguar nga zyrtaret e NQ Termokos. ZRRE e konsideron këtë dokument dhe e ka përfshirë në dosjen e shqyrtimit tarifor.
- ZRRE ka marrë parasysh komentin më lartë, dhe e konsideron të arsyeshëm duke marrë parasysh problemet me matjen e energjisë termike (rreth 25% deri 30% e nënstacioneve nuk maten sepse nuk kanë matës, si dhe çështjen e saktësisë se matjes), problemet në rrjetin sekondar që ndikojnë negativisht në kualitetin dhe sasinë e furnizimit me energji termike, dhe problemin e lagjes Kodra e Diellit, ku për arsye të disnivelit të relievit ka pengesa në furnizim cilësor me energji termike.
- Nga sa u tha më lartë, ZRRE në përcaktimin e tarifës ka zbatuar përcaktuesit e faturimit dhe është bazuar në vlerat faktike të kapacitetit termik dhe sasisë së energjisë termike të furnizuar(për konsumatorët me matje), dhe po ashtu sipërfaqet ngrohëse për konsumatorët pa matje. Gjithashtu ka vlerësuar edhe faturimin faktik të realizuar si dhe një rritje të planifikuar të parametrave të lartpërmendur.
- Këto që u përmenden më lartë kanë shërbyer si bazë për llogaritjen e tarifave me matje dhe atyre pa matje të cilat konsiderohen se janë në një nivel të pranueshëm dhe të mjaftueshëm për të arritur të Hyrat maksimale të lejuara.

Përgatitur nga DETG, ZRRE

